

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika AnchorFix®-3+

ADEZIV EPOKSID ME 2 PËRBËRËS PËR ANKORIM ME PERFORMANCË TË LARTË

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Adeziv ankorimi pa tretës, tiksotropik, me 2 përbërës, me bazë rrëshirë epokside dhe me performancë të lartë.

PËRDORIMET

Sika AnchorFix®-3+ duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë. Për fiksimin e ankorimeve të pazgjerueshme si më poshtë:

Punime strukturore:

- Ankorim shufrash / armaturash në punime të reja dhe restaurime
- Shufra të filetuara
- Bulona dhe sisteme të posaçme mbërthimi / fiksimi
- Instalim të shërbimeve mekanike dhe elektrike (ngrohje dhe ftohje, sanitare, etj)
- Ankorim i suporteve për kanalizimet dhe pajisjet

Punime mbi metal dhe dru:

- Fiksime i parmakëve, suporteve
- Fiksime i kangjellave
- Fiksime i kornizave të deryve dhe dritareve

Mbi nënshtresat e mëposhtme:

- Beton
- Mure solidë dhe zgavër
- Çelik
- Dru
- Gur natyror i fortë dhe i riformuar*
- Gur solid*

* Këto nënshtresa mund të ndryshojnë shumë, veçanërisht në lidhje me rezistencën, përbërjen dhe porozitetin. Prandaj, për çdo aplikim duhet të testohet përshtatshmëria e adezivit Sika AnchorFix®-3+ duke aplikuar më parë produktin mbi një zonë për provë. Kontrolloni veçanërisht rezistencën e ngjitjes, njollosjen e sipërfaqjes dhe çngjyrosjen.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Kohë e gjatë punueshmërie
- Mund të përdoret mbi beton të lagësht
- Kapacitet i lartë për bartje ngarkese
- ETA të ETAG 001 për ankorim mbi beton
- Nuk varet, edhe në aplikime tavanore
- Pa stiren
- Ngurtësim pa tkurrje
- Me pak erë
- Firo e pakët materiali

MIRATIME / STANDARDE

- Ankorim i ngjitur me metodën e injektimit sipas ETAG 001 Pjesa 1 dhe 5 Opsioni 7, ETA-14/0125, Deklaratë Performance dhe mbart markën CE.
- Produkt për ankorimin e armaturës prej çeliku sipas EN 1504-6:2006, Deklaratë Performance 0204030100300000021001, certifikuar nga organi i certifikimit të kontrollit të njoftuar të prodhimit në fabrikë 0921, certifikatë konformiteti nga kontrolli i prodhimit në fabrikë 0921-CPD-2056 dhe mbart markën CE.
- Testuar sipas NF/AFNOR standardi P 18-831

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi	2 tubeta bashkë nga 400 ml secila	12 tubeta/ kuti paleta: 60 kuti
Ngjyra	Përbërësi A Përbërësi B Përbërësit A+B të përzierë	i tejdukshëm gri gri e lehtë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit. Të gjitha tubetat Sika AnchorFix®-3+ kanë datën e skadencës të printuar mbi etiketë.	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.	
Dendësia	Përbërësi A Përbërësi B Përbërësit A+B të përzierë	~1.18 kg/l ~1.71 kg/l ~1.45 kg/l

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	Koha e tharjes	+5 °C	+23 °C	+40 °C	(ASTM D 695-96)
	16 orë	~11 N/mm ²	~94 N/mm ²	~108 N/mm ²	
	1 ditë	~17 N/mm ²	~104 N/mm ²	~115 N/mm ²	
	3 ditë	~86 N/mm ²	~112 N/mm ²	~123 N/mm ²	
	7 ditë	~89 N/mm ²	~114 N/mm ²	~127 N/mm ²	
Rezistenca ndaj shqitjes	Ngarkesa e fundit	> 70 kN*			(NF P 18-822)
	Shkarja/ rrëshqitja	< 0.6 mm			
* Ngarkesa max. për makinën e testimit Parametrat e testimit për ankorimin e shufrave në pllaka:					
Cilësia e çelikut		B500B			
Diametri i shufrës		12 mm			
Diametri i birës së shpuar		22 mm			
Thellësia e ankorimit		120 mm			
Temperatura e funksionimit	Afatgjatë	-40 °C min. / +50°C			(ETAG 001, Part 5)
	Afatshkurtër (1–2 orë)	+50 °C			

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 1 : 1 për vëllim
Trashësia e shtresës	5 mm max.
Rrjedha e varjes	Nuk varet, edhe në aplikime tavanore
Temperatura e produktit	Sika AnchorFix®-3+ duhet të jetë në temperaturë midis +5°C dhe +30°C për aplikim.
Temperatura e mjedisit	0 °C min. / +40 °C max.
Pika e vesës	Kujdes kondensimin. Temperatura e nënshtresës gjatë aplikimit duhet të jetë të paktën 3°C mbi pikën e vesës.
Temperatura e nënshtresës	0 °C min. / +40 °C max.

Temperatura	Koha e punueshmërisë - T _{gel}	Koha e tharjes - T _{cur} *
+35 °C – +40 °C	10 minuta	7 orë
+20 °C – +35 °C	15 minuta	14 orë
+10 °C – +20 °C	35 minuta	30 orë
+5 °C – +10 °C	75 minuta	45 orë

Temperatura min. e tubetës: +5 °C

* Në beton të lagësht koha e tharjes duhet të dyfishohet.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Llaçi dhe betoni duhet të kenë rezistencën e kërkuar.

Nuk nevojitet të kenë moshë 28 ditësh.

Rezistenca e nënshtresës (betoni, muri, guri natyror) duhet të verifikohet.

Duhet të kryhen teste të tërheqjes nëse rezistenca e nënshtresës është e panjohur.


Bira e ankorimit duhet të jetë gjithmonë e pastër, e thatë, pa vaj dhe graso, etj.

Grimcat e lira duhet të pastrohen nga birat.


Shufrat dhe armaturat e filetuara duhet të pastrohen plotësisht nga vaji, grasoja, apo substanca të tjera dhe grimcat si pislëqet, etj.

PËRZIERJA


Përgatitja e tubetës: 400 ml




1. Zhvidhosni kapakun



2. Hiqni tapën




3. Mbërtheni përzierësin statik



4. Vendosni tubetën tek pistoleta dhe filloni aplikimin


METODA E APLIKIMIT / MJETET

Ankorime në mur solid/beton



Shpuni birën me një trapan elektrik në diametrin dhe thellësinë e kërkuar.

Diametri i birës së shpuar duhet të përputhet me përmasat e ankorimit.




Bira e shpuar duhet të pastrohet me një pompë fryrjeje ose me kompresor ajri, duke filluar nga fundi i birës. (të paktën 2x)

Kujdes: përdorni kompresorë pa vaj!



Bira e shpuar duhet të pastrohet tërësisht me një furçë hekuri të posaçme (pastroni të paktën 2x).

Diametri i furçës duhet të jetë më i madh se diametri i birës së shpuar.




Bira e shpuar duhet të pastrohet me një pompë fryrjeje ose me kompresor ajri, duke filluar nga fundi i birës. (të paktën 2x)

Kujdes: përdorni kompresorë pa vaj!




Bira e shpuar duhet të pastrohet tërësisht me një furçë hekuri të posaçme (pastroni të paktën 2x).


Diametri i furçës duhet të jetë më i madh se diametri i birës së shpuar.




Bira e shpuar duhet të pastrohet me një pompë fryrjeje ose me kompresor ajri, duke filluar nga fundi i birës. (të paktën 2x)
Kujdes: përdorni kompresorë pa vaj!




Pomponi rreth dy herë derisa të dy përbërësit të dalin në mënyrë uniforme. Mos e përdorni këtë material që sapo doli. Lironi presionin e pistoletës dhe pastroni hapjen e tubetës me një copë.



Injektioni adezivin në birë, duke filluar nga fundi, ndërsa tërhiqni ngadalë prapa përzierësin statik. Në çdo rast shmangni hyrjen e ajrit. Për zgjerimin më të thellë të birës mund të përdoret tub.



Futni ankorimin me lëvizje rrotulluese brenda në birën e mbushur. Një sasi e vogël adezivi duhet të dalë jashtë birës. Kujdes: ankorimi duhet të vendoset brenda kohës së punueshmërisë.



Ndërkohë që rrëshira forcohet ankorimi nuk duhet të lëvizet apo t'i vendoset ngarkesë përsipër. Mirëmbajtja e pajisjeve bëhet duke përdorur Sika® Colma Cleaner. Shpëlani mirë duart dhe lëkurën me ujë të ngrohtë dhe sapun.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Sika® Colma Cleaner menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Për informacione specifike mbi dizajnin referohuni tek dokumentacioni që ofrohet:

Dokumentacion teknik Sika AnchorFix®-3+ 870 43 08

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika AnchorFix®-3+

Mars 2019, Botimi 01.01

020205010030000002

SikaAnchorFix-3+sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf